



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 693/1 Prot.

Tiranë, më 10. 05. 2019

V E N D I M

Nr. 60, Datë 10. 05. 2019

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 156, datë 02.10.2018, të bërë nga I. B., kundër Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “*bindjes politike*¹”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, I. B. ka filluar marrëdhëniet e punës pranë Albpetrol sh.a., që prej datës 27.01.2014, në pozicionin Specialiste Arshive pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Administratës. Më datë 27.01.2016, është liruar nga kjo detyrë dhe është transferuar në pozicionin Sekretare/Arshiviste pranë Qendrës së Prodhimit të Naftës Patos (në vijim QPN).

Në kuadër të ristrukturimit organizativ dhe të reduktimit të fuqisë punëtore të Shoqërisë Albpetrol sh.a. Patos, me shkresën Nr. 5533/2 prot., datë 02.07.2018, Administratori i Shoqërisë Albpetrol sh.a., ka vënë në dijeni QPN Fier, mbi Strukturën Organizative të Qendrës, në të cilën sipas ankueses, pozicioni që ajo mbante nuk ka pësuar asnjë ndryshim, mbi kriteret e pozicionit të punës.

Me shkresën Nr. 6811 prot., datë 27.07.2018, ankuesja është njoftuar se marrëdhënia e punës me shoqërinë Albpetrol sh.a., për shkak të reduktimit të fuqisë punëtore dhe mos plotësimit të kriterëve të mjaftueshme të pozicionit të punës, do të ndërpritej me datë 30.09.2018. Në këto

¹ Nga fotot bashkëngjitur ankesës, evidentohet pjesëmarrja e ankueses në aktivitetet politike të subjektit politik, Partia “*Lëvizja Socialiste për Integrim*”.

kushte me shkresën Nr. 519/1 prot., datë 30.07.2018, ankuesja i është drejtuar Komisionit të Vlerësimit dhe Shqyrtimit të Ankesave, duke kërkuar anulimin e procedurës së largimit nga pozicioni i punës. Në të njëjtën datë, më 30.07.2018, Komisioni i Vlerësimit dhe Shqyrtimit të Ankesave, ka mbajtur proces-verbalin e njoftimit për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, ku ankuesja është shprehur se largimi nga puna po bëhet për shkak të bindjeve të saj politike dhe për asnjë shkak tjetër.

Sipas ankueses, pavarësisht faktit që është vlerësuar nga Komisioni i Vlerësimit dhe Shqyrtimit të Ankesave me 60 (gjashtëdhjetë) pikë, ajo është larguar nga detyra dhe është zëvendësuar nga E. V., e cila është vlerësuar me 45 (dyzet e pesë) pikë.

Gjithashtu, ankuesja thekson se Albpetrol sh.a., gjatë 6 muajve të parë të vitit 2018, ka marrë në punë rreth 34 (tridhjetë e katër) punonjës të rinj, të cilët vijojnë të jenë ende në punë, ndërsa pjesa më e madhe e punonjësve anëtarë të LSI-së, janë larguar nga detyra.

E ndodhur në këtë situatë, ankuesja pretendon se është diskriminuar nga punëdhënësi i saj gjatë procedurave për largimin nga puna, pasi arsyet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës lidhen me bindjet politike.

Në përfundim, ankuesja kërkon nga Komisioneri, konstatimin e trajtimit të pabarabartë dhe diskriminues nga ana e punëdhënësit, Albpetrol sh.a. dhe rekomandimin e rikthimit në pozicionin e mëparshëm të punës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

² Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 156, datë 02.10.2018 të I. B. u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 1345/1, datë 17.10.2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar Albpetrol sh.a për ankesën e bërë nga I. B., si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
 - Kopje të procedurës së largimit nga detyra të punonjësës I. B.
 - Kopje të kontratës, librezës, vlerësimit të punës, arsimit dhe kualifikimit të I. B.

Me shkresën nr. 10121/1 prot., datë 23.11.2018, të administruar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me nr. 1355/4, datë 03.12.2018, Albpetrol sh.a në mes të tjerash informoi se: *“I. B. ka qenë punonjëse e Shoqërisë Albpetrol sh.a nga data 27.01.2014 deri në datë 29.10.2018. Gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënieve të punës me shoqërinë Albpetrol sh.a., I. B. ka pasur ndryshime të pozicionit të punës duke mbajtur detyrat: Specialiste Protokolli pranë Shoqërisë Albpetrol sh.a., nga data 27.01.2014, deri më datë 31.10.2014; Specialiste pranë Drejtorisë së Marketingut dhe Marrëdhënieve me Publikun, nga data 31.10.2014 deri më datë 31.01.2016; Sekretare Arshiviste pranë Qendrës së Prodhimit të Naftës Patos, nga data 01.02.2016, deri më datë 01.04.2018 dhe së fundmi Sekretare Arshiviste pranë Qendrës së Prodhimit të Naftës Fier, nga data 01.04.2018, deri më datë 29.10.2018. Në zbatim të Programit të Zhvillimit të Rishikuar për vitin 2018, i miratuar me vendim nr. 8, datë 07.06.2018 të Këshillit Mbikëqyrës të “Albpetrol” sh.a dhe Vendimin nr. 496/10, datë 25.06.2018 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqëria Albpetrol sh.a është në proces ristrukturimi për reduktimin e fuqisë punëtore dhe për këtë arsye ka ndërmarrë hapat për nisjen e procedurave të pushimit kolektiv. Në kuadër të këtij procesi është nënshkruar Akt-Marrëveshje me Organizatën Sindikale përfaqësuese të punëmarrësve, për përcaktimin e kriterëve mbi të cilat do të kryhet procedura e pushimit kolektiv. Për kryerjen e vlerësimit me pikë, mbi bazën e të cilit janë përzgjedhur se do të qëndrojnë në punë ata punonjës të cilët janë vlerësuar me më shumë pikë. Kriteret mbi bazën e të cilave u krye vlerësimi, u përcaktuan: - Arsimi, - Kualifikimi, - Vjetërsia, - Treguesit e punës, etj. Për të gjitha këto është arritur një marrëveshje e përbashkët midis Shoqërisë Albpetrol sh.a., në cilësinë e punëdhënësit dhe Sindikatës së Re të Naftëtarëve në cilësinë e subjektit i cili mbron interesat e punëmarrësve. Kjo sindikatë ka të nënshkruar edhe Kontratën Kolektive në fuqi me Shoqërinë Albpetrol sh.a. Një nga fazat e procesit të*

ristrukturimit organizativ të shoqërisë Albpetrol ishte bashkimi i QPN Patos me QPN Ballsh dhe krijimi i një qendre të re pune me emërimin Qendra e Prodhimit të Naftës Fier, me pasojë shkurtimin e 175 vende pune. Për këtë arsye, punonjësit e QPN Patos dhe Ballsh i janë nënshtruar procesit të vlerësimit dhe pikëzimit të kryer nga komisioni përkatës i ngritur në zbatim të Urdhërit të Administratorit nr. 50, datë 02.07.2018. Referuar procesit të vlerësimit dhe pikëzimit të kryer për punonjësit e QPN Fier, rezulton se I. B. nuk plotësonte kriteret e mjaftueshme për vazhdimin e marrëdhënies së punës. Për këtë arsye është njoftuar rregullisht me shkresën Nr. 6811 prot., datë 27.07.2018, mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të shkurtimit të vendit të punës, bazuar në nenin 143 dhe 148 të Kodit të Punës. Në total, nga procesi i ristrukturimit të Shoqërisë Albpetrol sh.a., janë prekur rreth 450 punonjës të cilët janë njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të ristrukturimit të Albpetrol sh.a., bazuar në nenin 143 dhe 148 të Kodit të Punës. Ndërprerja e marrëdhënieve të punës me punonjësen I. B., për shkak të numrit të punonjësve të cilët janë përfshirë në këtë proces, referuar nenit 148, pika 1 të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, nuk vlerësohet si pushim individual, por si pushim kolektiv. Kjo do të thotë se marrëdhënia punëdhënës-punëmarrës, pra raporti midis Shoqërisë Albpetrol sh.a. dhe I. B. nuk është aspak individual dhe i lidhur me pretendimin e saj se është njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të bindjeve politike. Në asnjë praktikë apo shkresë të punëdhënësit Albpetrol sh.a. nuk është përmendur përkatësia e ndonjë prej punonjësve. Gjithashtu, në Shoqërinë Albpetrol sh.a., janë paraqitur ankesa (të administruara edhe nga ju) nga punonjës të prekur nga ristrukturimi të cilët pretendojnë përkatësinë dhe bindje të ndryshme politike, fakt i cili hedh poshtë pretendimin e diskriminimit për shkak të bindjeve politike. Pala ankuese, I. B. ka barrën e provës të vërtetë me prova shkresore që Punëdhënësi, pra personi juridik Albpetrol sh.a., ka qënë zyrtarisht në dijeni të përkatësisë politike të ankimuesit, pasi është logjike që, ta diskriminosh dikë për shkak të bindjeve politike, duhet të kesh dijeni mbi përkatësinë politike apo bindjet politike përkatëse. Nga verifikimet e kryera në dosjen personale që disponojmë për I. B., nuk rezulton asnjë e dhënë mbi përkatësinë politike.”.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 159, datë 08.10.2018, Komisioneri me shkresat nr. 1345/3 prot., datë 05.12.2018; nr. 1345/4 prot., datë 12.12.2018; nr. 253 prot., datë 14.02.2019 dhe nr. 279 prot., datë 18.02.2019, pasi mori miratimin e palëve në proces, njoftoi zhvillimin e seancës dëgjimore në datë 22.02.2019 duke kërkuar shpjegime dhe kopje të dokumenteve si më poshtë:
 - Pretendimet e ngritura në ankesë nga ana e I. B.
 - Punonjësin që ka zëvendësuar I. B. (kopje të dokumentacionit lidhur me arsimin).

Seanca u zhvillua me praninë e të dy palëve në proces: subjektit ankues, nëpërmjet përfaqësuesit me prokurë të posaçme³, L. Sh. dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësuesve me autorizim⁴ të Shoqërisë Albpetrol sh.a, Y. S, A. I. dhe A. M.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, të dyja palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Përfaqësuesi ligjor i ankueses parashtroi edhe një herë pretendimet për diskriminim të I. B., ku theksoi faktin se përfshirja e ankueses në pushimin kolektiv të Albpetrol sh.a, ka patur si shkak bindjen politike të ankueses, e cila është anëtare e subjektit politik, Lëvizja Socialiste për Integrim. Përfaqësuesi ligjor i ankueses, shpjegoi faktin se duke filluar nga Ministri i linjës, Bordi i Mbikëqyrjes së Shoqërisë, pjesa më e madhe e drejtuesve të Shoqërisë Albpetrol sh.a si dhe anëtarët e Komisionit të Vlerësimit dhe Pikëzimit, janë drejtues dhe anëtarë të Partisë Socialiste. Gjithashtu deklaroi se procesi i pikëzimit nuk ka qenë transparent dhe se sipas tij ankuesja duhet të kishte marrë pikë më shumë krahasuar me punonjësen e emëruar në pozicionin e arshivistes në QPN Fier, duke qënë se ajo nuk ka arsimin përkatës, pasi ka vetëm diplomë Bachelor. Masa disiplinore e I. B. e marrë në vitin 2016 duhej të ishte parashkruar dhe nuk duhej të merrej parasysh për vlerësimin e saj. Në përfundim, përfaqësuesi i ankueses, sqaroi se I. B. nuk i është miratuar kërkesa për lejen e pashfrytëzuar, duke u trajtuar në mënyrë të pabarabartë në raport me shtetasin P. B., i cili ka përfituar lejen.

Nga ana e përfaqësuesve të Shoqërisë Albpetrol sh.a, u theksua fakti se largimi i I. B. nga puna është bërë pasi, punonjësit e QPN Patos dhe Ballsh i janë nënshtruar procesit të vlerësimit dhe pikëzimit të kryer nga komisioni përkatës i ngritur në zbatim të Urdhrit të Administratorit nr. 50, datë 02.07.2018. Referuar procesit të vlerësimit dhe pikëzimit të kryer për punonjësit e QPN Fier, rezultoi se I. B. nuk plotësonte kriteret e mjaftueshme për vazhdimin e marrëdhënies së punës. Për këtë arsye është njoftuar rregullisht, mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të shkurtimit të vendit të punës. Në vijim u theksua fakti se ankuesja ka kërkuar lejen e vjetore, pasi është vënë në dijeni të njoftimit për shkurtimin e pozicionit të punës, si dhe gjatë periudhës së njoftimit I. B. ka paraqitur 2 raporte. Megjithatë, I. B. si edhe punonjës të tjerë të Albpetrol sh.a., për lejen e pashfrytëzuar kanë përfituar shpërblimin përkatës⁵. Sa i përket krahasimit me shtetasin P. B., përfaqësuesit e Albpetrol theksuan se, nuk mund të krahasohen këta dy punonjës për faktin se ndërprerja e kontratës së punës me shtetasin P. B., është bërë për shkak të rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe ai nuk ishte pjesë e pushimit

³ Me nr. 3582 Rep. dhe Nr.1575 Kol.

⁴ Me shkresën me nr. 119 prot., datë 07.01.2019.

⁵ Referuar deklaramit gjatë seancës dëgjimore.

kolektiv nga puna. Sa i përket punonjësës që pretendohet se ka zëvendësuar ankuesen, në detyrën e arshivistes, përfaqësuesit e Albpetrol sqaruan se në dijeninë e tyre, ajo është anëtare e subjektiv politik Partia Demokratike e Shqipërisë dhe nëse Shoqëria Albpetrol do të mbante parasyshtë bindjet politike në procedurat e pushimit kolektiv nga puna, E. V. nuk do të ishte punonjëse në këtë shoqëri. Gjithashtu, përfaqësuesit e Albpetrol deklaruan se mbështetur në tabelën e pikëzimit, E. V., ka 65 pikë në raport me 60 pikë që ka ankuesja. Fakti që ankuesja e kishte bashkëshortin të dënuar dhe ishte nënë e 3 fëmijëve, ishte edhe një arsye më shumë për ta mbajtur në punë E. V. Lidhur me masën disiplinore të dhënë nga punëdhënësi për I. B. në vitin 2016, përfaqësuesit e Albpetrol deklaruan se masa disiplinore e dhënë ndaj ankueses është përmendur si referencë por që nuk ka ndikuar në vlerësimin e ankueses⁶. Në përfundim, përfaqësuesit e Albpetrol shtuan se, nga bashkimi i dy ndërmarrjeve QPN Ballsh dhe QPN Patos, u krijua QPN Fier dhe nga dy pozicione arshiviste mbeti një. Një nga arshivistet e qëndrave kaloi në një pozicion tjetër pune, ndërsa punonjësit e tjerë ju nënshtruan konkurimit për pozicionet e mbetura. Nga konkurimi rezultoi që I. B. nuk mori pikët e duhura në raport me E. V. dhe për këtë shkak iu ndërpre në marrëdhëniet e punës.

- Në vijim të procedurës hetimore për marrjen e çdo prove dhe informacioni që i shërben procesit, shoqëria Albpetrol, me shkresën⁷ Nr. 2665 prot., datë 21.03.2019, vuri në dispozicion të KMD-së, procedurën e vlerësimit dhe të pikëzimit të kryer në QPN Fier dhe kopje të dokumentacionit që përmban dosja personale e shtetases E. V.

Në vijim të seancës dëgjimore, përfaqësuesi ligjor i ankueses me e-mail-in datë 25.04.2019, sqaroi ndër të tjera se: *"... nga shoqëria Albpetrol sh.a., nuk janë sjellë aktet që kanë të bëjnë me pikëzimin dhe komisionet që kanë përzgjedhur punëmarrësit për tu larguar nga vendi i punës. Referuar edhe nenit 12 të ligjit 10221 , dt 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" , nenit 9 të Kodit të Punës, mendoj se ankuesja I. B. është diskriminuar sikurse mund të ketë edhe shumë punonjës të tjerë referuar edhe provave të tjera që unë po ju dërgoj një pjese e të cilave ekzistojnë. Sipas urdhërit nr. 50 , dt. 02.07.2018 të Administratorit të shoqërisë Albpetrol sh.a., pika 2 i jep të drejtën drejtorit të QPN të krijojë komisionet e ristrukturimit dhe sipas pikës 7 të këtij urdhëri çdo akt duhet të jetë i firmosur nga çdo anëtar i komisionit. Sipas urdhërit të brendshëm nr. 420 dt. 03.07.2018 të drejtorit të QPN Fier anëtar komisioni janë: P. Sh., A. M., S. P., A. V., Rr. C., A. K. Sipas proceverbalit nr. 1, dt. 03.07.2018 nuk rezulton të jetë anëtar komisioni A. K., por D. Xh. Ky në kundërshtim edhe me shkresën nr. 5537 prot. , dt 02.07.2018 me lëndë "Njoftim lidhur me anëtarët e komisioneve të autorizuar nga Sindikata e Re e Naftëtarëve" të administratorit të Albpetrol sh.a., ku për QPN Fier anëtarë ka qënë A. K. dhe jo D. Xh. Nuk ka asnjë shkresë për zëvendësim të anëtarit të sindikatës për këtë Komision në QPN Fier. Në dt. 03.07.2018 është urdhëri i drejtorit të QPN Fier për formimin e komisionit dhe po në dt. 03.07.2018 është paraqitur një punonjës si përfaqësues i sindikatës i pa konfirmuar nga*

⁶ Referuar deklaramit gjatë seancës dëgjimore.

⁷ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 480 prot., datë 27.03.2019.

drejtori apo sindikata për zëvendësim me ish sindikalistin tjetër. Në të 5 procesverbalet që janë hartuar për ristrukturimin e QPN Fier për shkurtim punonjësish nuk janë firmosur nga të gjithë anëtarët, duke nisur nga Drejtori i qendrës. Këta anëtarë të komisionit që kanë firmosur, konkretisht A. M. që është shefe e burimeve njerëzore në sektorin Ballsh Hekal është anëtare e PS dhe këshilltare e Këshillit Bashkiak Mallakastër, A. V. anëtar i PS dhe kryetar i Këshillit Bashkiak Patos, S. P. anëtar i PS dhe D. Xh. anëtar i PS-së. Sipas akt marrëveshjes mes Albpetrol sh.a dhe sindikatës është rënë dakord që të hiqen 20 % e punonjësve që në korrik 2018 kanë qënë 2381 punonjës dhe kjo shifër është tejkaluar duke nxjerrë edhe punonjës të cilët janë kundërshtar politik.”

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

I. B. ka qënë punonjëse e Shoqërisë Albpetrol sh.a nga data 27.01.2014. Gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënieve të punës me shoqërinë Albpetrol sh.a., I. B. ka pasur ndryshime të pozicionit të punës duke mbajtur detyrat: Specialiste Protokolli pranë Shoqërisë Albpetrol sh.a., Specialiste pranë Drejtorisë së Marketingut dhe Marrëdhënieve me Publikun, Sekretare Arshiviste pranë Qendrës së Prodhimit të Naftës Patos dhe së fundmi Sekretare Arshiviste pranë Qendrës së Prodhimit të Naftës Fier.

Me shkresën nr. 6811, datë 27.07.2018 është njoftuar mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të pushimit kolektiv, ndërsa me Vendimin nr. 913, datë 29.10.2018 të Albpetrol sh.a, ankueses i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për shkak të ristrukturimit organizativ të Shoqërisë Albpetrol sh.a. Ankuesja, duke mos rënë dakord me njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, me shkresën nr. 519/1 prot., datë 30.07.2018 “Ankesë” është ankuar lidhur me njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës duke shpjeguar se plotësonte kriteret bazë të pikëzimit, pasi vendi i punës nuk mbyllej, arsimin e ka të lartë, nuk ka masa disiplinore dhe pozicioni i punës së saj nuk shkurtohej. Nga deklaratat e palëve rezulton se Shoqëria Albpetrol sh.a nuk i ka kthyer përgjigje ankesës së I. B. Pavarësisht se nuk ka marrë përgjigje për ankesën e bërë, I. B. ka vazhduar marrëdhënien e punës pranë QPN Fier dhe nuk e ka kundërshtuar në rrugë gjyqësore procesin e vlerësimit dhe pikëzimit të cilën e konsideron të padrejtë.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se mbështetur në Programin e Zhvillimit të Rishikuar për vitin 2018, të miratuar me Vendimin nr. 08, datë 07.06.2018, të Këshillit Mbikqyrës dhe Vendimin nr. 496/10, datë 25.06.2018, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Shoqëria Albpetrol sh.a. i është nënshtruar procesit të ristrukturimit të saj, si rrjedhojë e të cilit i janë nënshtruar pushimit kolektiv rreth 450 punonjës, që bëjnë pjesë në administratën e kësaj Shoqërie dhe në qendrat e prodhimit e shërbimit në varësi të saj. Nga përmbajtja e akteve të sipërpërmendura rezulton se ky është një proces madhor që po ndodh në këtë Shoqëri, si pasojë e ndryshimeve të treguesve kryesorë të Programit të Zhvillimit Ekonomik të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. për vitin 2018.

Në nenin 147, pika 1, të Kodit të Punës parashikohet: *“Vlerësohet pushim kolektiv nga puna përfundimi i marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi, për arsye që nuk kanë të bëjnë me punëmarrësin, kur numri i pushimeve nga puna, brenda 90 ditëve, është, të paktën, 10 punëmarrës për ndërmarrjet me deri në 100 punonjës; 15, për ndërmarrjet me mbi 100 deri në 200 punonjës; dhe 20, për ndërmarrjet me mbi 200 punonjës”*. Numri i punonjësve që i janë nënshtruar pushimit kolektiv pranë Albpetrol sh.a ka qenë rreth 450, fakt që konsiderohet si një pushim kolektiv me përmasa të mëdha.

Në pikën 02, të Vendimit nr. 496/10, datë 25.06.2018, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë “Mbi miratimin e ndryshimit të programit të zhvillimit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. për vitin 2018” parashikohet shprehimisht: *“Miratimin e procesit të ristrukturimit organizativ të njësisive të Shoqërisë, reduktimit të fuqisë punëtore, strukturës organizative dhe miratimin e numrit total të punonjësve, sipas Vendimit të Këshillit Mbikqyrës nr. 8, datë 07.06.2018, pikat 2, 3, 4, 5 dhe 6”*.

Në pikën 2, të Vendimit nr. 8, datë 07.06.2018, të Këshillit Mbikqyrës të Albpetrol sh.a miratohet procesi i ristrukturimit organizativ të shoqërisë dhe reduktimit të fuqisë punëtore, si dhe parashikohet përfundimi i këtij procesi brenda datës 01.10.2018. Në pikën 3 të vendimit në fjalë miratohet Struktura Organizative e Shoqërisë “Albpetrol” sh.a me përbërje 3 (tre) Qendra të Prodhimit të Naftës, 7 (shtatë) Qendra Shërbimi dhe Administrata Qendrore. Në këtë vendim miratohet gjithashtu edhe numri total i punonjësve të Shoqërisë prej 1,828 punonjës, pas përfundimit të procesit të ristrukturimit organizativ, të shpërndarë sipas qendrave respektive.

Në kushtet kur fuqia punëtore e kësaj shoqërie do të reduktohej me rreth 450 punonjës, si dhe duke patur parasysh faktin se ndërmjet Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë (SRNSH) dhe Albpetrol sh.a. është lidhur një kontratë kolektive⁸ për punonjësit e kësaj shoqërie, në referencë të nenit 148, pika 3, të Kodit të Punës, Albpetrol sh.a. bëri këshillime me organizatën sindikale, e njohur si përfaqësuese e punëmarrësve, me qëllim që të arrihet një marrëveshje. Në këtë kontekst

⁸Kontrata Kolektive e Punës nr. 8781, datë 29.12.2017, lidhur ndërmjet Shoqërisë “Albpetrol” sh.a. dhe Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë (SRNSH).

u realizuan takime me sindikatën e sipërpërmendur në mënyrë që të përcaktoheshin kriteret për kryerjen e reduktimit të fuqisë punëtore dhe rregullat e përgjithshme, të cilave do t'u nënshtroheshin punonjësit e kësaj shoqërie të cilët do t'i nënshtroheshin pushimit kolektiv në punë.

Në bazë të Akt-Marrëveshjes së lidhur ndërmjet Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë (SRNSH) dhe Albpetrol sh.a., si dhe Shtojcës 1 në vijim të kësaj Akt-Marrëveshjeje, kriteret të cilat do të merreshin në konsideratë gjatë procesit të ristrukturimit të shoqërisë dhe reduktimit të fuqisë punëtore ishin: (1) Arsimi, (2) Kualifikimi profesional/kategoria/patent specifike dhe (3) Vjetërsia në punë në industrinë e naftës. Përzgjedhja e punonjësve sipas kriterëve të përcaktuara më sipër do të kryhej sipas vlerësimit me pikë të përcaktuar në këtë marrëveshje. Sipas shpjegimeve të dhëna nga strukturat e Albpetrol sh.a., vlerësimit nëpërmjet sistemit të pikëzimit do t'i nënshtroheshin vetëm ata punonjës, të cilët kishin pozicione të njëjta punë, ndërkohë që nga këto pozicione, disa prej tyre suprimoheshin. Punonjësit, që kishin pozicion pune unik ose të vetëm dhe ky pozicion shkurtohej, nuk i nënshtroheshin vlerësimit nëpërmjet sistemit të pikëzimit.

Në vijim, Albpetrol sh.a miratoi aktet nënligjore, nëpërmjet së cilave përcaktoi rregullat e hollësishme, lidhur me mënyrën, se si do të kryhej ristrukturimi dhe reduktimi i fuqisë punëtore. Aktet përkatëse konsistojnë në Urdhërin nr. 49, datë 02.07.2018, e Administratorit për fillimin e procesit të ristrukturimit organizativ dhe reduktimin e fuqisë punëtore të Albpetrol sh.a; Urdhërin nr. 50, datë 02.07.2018, e Administratorit për ngritjen e Komisioneve dhe kryerjen e procesit të ristrukturimit, si dhe Shtojcën nr.1 e cila është pjesë integrale e këtij urdhëri; Urdhërin nr.51, datë 02.07.2018, të Administratorit për përcaktimin e përfaqësuesve të administratës që do të jenë pjesë e komisioneve në Qendrat e Prodhimit dhe Shërbimit, si dhe Urdhërin nr. 63, datë 16.07.2018, të Administratorit të Albpetrol sh.a., lidhur me procedurën e kontrollit dhe Administrimit të procesit të ankimimeve të punonjësve që preken nga ristrukturimi dhe reduktimi i fuqisë punëtore të Albpetrol sh.a.

Në referencë të Akt-Marrëveshjes me Sindikatën e Naftëtarëve, Shoqëria Albpetrol sh.a iu drejtua të gjithë qendrave në varësi të saj, me shkresën nr. 5537, datë 02.07.2018, nëpërmjet së cilës i njoftonte në lidhje me përfaqësuesit e Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë, që do të ishin pjesë e komisioneve të vlerësimit të ngritura në çdo qendër.

Në referencë të Vendimit nr. 08, datë 07.06.2018, të Këshillit Mbikqyrës së Albpetrol sh.a, "Mbi programin e zhvillimit ekonomik të rishikuar për vitin 2018", pas kryerjes së ristrukturimit të shoqërisë, numri i përgjithshëm i punonjësve të Qendrës së Prodhimit të Naftës Fier pas ristrukturimit do të ishte 406, me pasojë shkurtime të 175 vendeve të punës⁹.

⁹ Referuar shkresës nr. 10116/1, datë 23.11.2018 të Albpetrol sh.a, parag 4.

Në referencë të përcaktimeve të Urdhërit nr. 50, datë 02.07.2018, të Administratorit për ngritjen e Komisioneve dhe kryerjen e procesit të ristrukturimit, si dhe Shtojcës nr.1, e cila është pjesë integrale e këtij urdhëri, Komisioni i vlerësimit pranë kësaj qendre ka vlerësuar me pikëzim punonjësit e QPN Fier. Sikurse është përmendur edhe më sipër, kriteret mbi të cilat u krye vlerësimi me pikëzim, sipas urdhërit të sipërpërmendur ishin: (1) Arsimi, (2) Kualifikimi profesional/kategoria/patent specifike dhe (3) Vjetërsia në punë në industrinë e naftës.

Referuar strukturës së miratuar me Vendimin nr. 209, datë 27.03.2018 të Administratorit të Shoqërisë Albpetrol sh.a, pozicioni i punonjësës I. B. ishte, Sekretare Arshiviste pranë Qendrës së Prodhimit të Naftës Fier dhe arsimi për këtë pozicion duhet të ishte, “I lartë, i mesëm” dhe specialiteti, “Ing., teknik, ekonomik, etj”.

Referuar shkresës nr. 5533/2, datë 02.07.2018 “Për zbatim strukture” drejtuar QPN Fier, pozicioni i punës, Arshiviste nuk ka ndryshuar dhe për këtë pozicion, është përcaktuar se arsimi duhet të ishte, “I lartë, i mesëm”.

Mbështetur në këto kriteret, duke iu referuar dokumentit: “Pikëzimi i strukturës organizative ekzistuese të ish-QPN Patos”, rezulton se punonjësja I. B. ka në total 60 pikë dhe është vlerësuar me: 50 pikë, për arsimin e lartë që përputhet me vendin e punës dhe 10 pikë për vjetërsinë në punë nga 1 deri 10 vjet.

Referuar po të njëjtit dokument, rezulton se punonjësja E. V. ka në total 65 pikë dhe është vlerësuar me: 50 pikë, për arsimin e lartë që përputhet me vendin e punës dhe 15 pikë për vjetërsinë në punë nga 10 deri 20 vjet.

Referuar dokumenteve të dorëzuara nga palët, rezulton se ankuesja I. B., zotëron Diplomë të Nivelit të Parë në Gjuhën Angleze dhe Diplomë Master i Shkencave në Mësuesi¹⁰, ndërsa punonjësja me të cilën krahasohet ankuesja E. V., zotëron Diplomë të Nivelit të Parë për Drejtësi dhe Diplomë Master i Shkencave Shoqërore në Qeverisje dhe Administrim Publik¹¹.

Mbështetur në sa më sipër, Komisioneri gjykon se përzgjedhja e kryer nga Komisioni i Vlerësimit është bërë duke u mbështetur në tre kriteret e përcaktuara: Arsim, Kualifikim, Vjetërsi në punë.

Në përfundim të këtij vlerësimi ka rezultuar se punonjësi E. V. është vlerësuar me 65 pikë në total. Subjekti ankues krahasuar me këtë punonjëse është penalizuar për shkak të vjetësisë në punë¹², si kërkesë për pozicionin e Arshiviste në strukturën e re të QPN Fier. Ankuesja kishte 4 vite e 6 muaj munë në Shoqërinë Albpetrol, ndërsa punonjësja E. V., kishte 11 vite punë.

¹⁰ Universiteti “Ismail Qemali” Diplomë nr. Serie 318, lëshuar në Maj 2010. Universiteti i Tiranës, Listë Notash, datë 13.09.2012.

¹¹ Universiteti “Kristal” Diplomë nr. 687, datë 03.08.2009. Albanian University, Diplomë datë 19.07.2012

¹² Kriteri i kërkuar është arsim i lartë ose i mesëm.

Në kontekst të sa më sipër, Komisioneri gjykon se subjekti ankues nuk është ekspozuar para një trajtimi të pabarabartë dhe disfavorizues nga ana e Albpetrol sh.a krahasuar me punonjës të E. V., e cila ka rezultuar si fituese në përfundim të procesit të vlerësimit.

Komisioneri, vlerëson se punonjësja E. V. për shkak të vjetësisë në punë është vlerësuar me më shumë pikë se ankuesja, nga ana e Komisionit të Vlerësimit dhe ky ka qenë elementi që ka prevaluar në shpalljen e saj si fituese e pozicionit Arshiviste në QPN Fier.

Pra, vetë ankuesja I. B. nuk është në kushtet e vlerësimit me pikë të barabarta nga ana e Komisionit, që të mund të merrej në konsideratë, për efekt krahasimor elementi “bindja politike”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në nenin 12/1/c) të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimit dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.*

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Nga analiza e provave të vëna në dispozicion nga palët, Komisioneri vlerëson se nuk kemi një trajtim të padrejtë apo të pafavorshëm të subjektit ankues.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se Albpetrol sh.a. nuk ka ndërmarrë veprime që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj ankuses, ose që e kanë ekspozuar atë, ndaj një trajtimi të

padrejtë dhe jo të barabartë, në krahasim me persona të tjerë, që ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme me të.

Në mungesë të një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm e të pabarabartë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a për shkakun e pretenduar nga ankuesja.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/c), nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetasës I. B. nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a për shkak të “bindjes politike”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Bindjet Politike)

(Fusha: Punësim)